

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kontratat 1 euro, hapet rruga për blerjen e pronës, shteti mund ta rimarrë nëse shkelen kushtet
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/kontratat-1-euro-hapet-rruga-per-blerjen-e-prones-shteti-mund-ta-rima-i514171
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 05:32:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 05:16:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6a84d9dde045d873962c8d4d6bceee9cdc2896f08efa9c00ecc5e90973cd9485
TEKSTI	7afb909094c575ab8ad4ba53e0a41ea07856497a84055de6537a5fb58767a1d
PAMJA	b83de36e278330bd68218d613babf2cd2582af1c86231e89074fe87ef8d125bf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	21e9b28c04b8c7f3bb51d655dd754b1e66bc54d8d3bf4d5aee3eb3913e9c84d2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	07dcd14af433ca62f57d8764b5c6075704d5b7e87042b539795708e53d505cef
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/21e9b28c04b8c7f3bb51d655dd754b1e66bc54d8d3bf4d5aee3eb3913e9c84d2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

11 ORE ME PARE

107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

12 ORE ME PARE

Më 16 shtator jepet vendimi për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së/ Kurti: Uroj të kthehen të lirë. Ambasada e SHBA në Prishtinë: Priten protesta, kini kujdes

16 ORE ME PARE

"Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

20 ORE ME PARE

Protestë të Zogu i Zi/ Shoqërohen 10 qytetarë nga policia, disa prej tyre dhunohen me grushta

Aktualitet

Kontratat 1 euro, hapet rruga për blerjen e pronës, shteti mund ta rimarrë nëse shkelen kushtet

Sipas udhëzimit nr. 7, subjektet që kanë marrë prona shtetërore me sipërfaqe mbi 500 metra katrorë me kontrata qiraje ose enfiteoze me tarifën "1 euro/kontrata" mund të kërkojnë blerjen e tyre, me kusht që prona të mos jetë e patjetërsueshme.



15 Shtator 2026, 07:16
Nga E.d



Foto ilustruese

Qeveria ka ndryshuar rregullat për përdorimin dhe privatizimin e pronave shtetërore, duke përcaktuar kushtet kur subjektet me kontrata me tarifën simbolike 1 euro mund të kërkojnë blerjen e pasurisë, si dhe sanksionet kur nuk realizohen investimet ose vendet e punës të marra përsipër.

Ndryshimet janë bërë përmes dy udhëzimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, nr. 6 dhe nr. 7, të datës 1 shtator 2026. Udhëzimi nr. 6 rregullon dhënien me qira dhe enfiteozë të pasurive shtetërore, ndërsa udhëzimi nr. 7 ndryshon procedurat për vlerësimin, privatizimin dhe shitjen e tyre.

Sipas udhëzimit nr. 7, subjektet që kanë marrë prona shtetërore me sipërfaqe mbi 500 metra katrorë me kontrata qiraje ose enfiteoze me tarifën "1 euro/kontrata" mund të kërkojnë blerjen e tyre, me kusht që prona të mos jetë e patjetërsueshme.

Për t'u shqyrtuar kërkesa, subjekti duhet të ketë realizuar brenda afatit kontraktor "investime në vlerë mbi 5,000,000 euro dhe në një vlerë më të lartë se 750 për qind e vlerës së pasurisë shtetërore objekt i kërkesës për blerje". Përbushja e këtyre kushteve duhet të vërtetohet me dokumentacion kontraktor, financiar dhe teknik.

Po sipas udhëzimit nr. 7, blerja e pronës nuk e çliron subjektin nga detyrimi për të realizuar investimin e plotë të parashikuar në planin e biznesit dhe në kontratën e mëparshme të qirasë ose enfiteozës. Ky detyrim duhet të përfshihet në kontratën e shitjes dhe të pasqyrohet si kufizim në kartelën e pasurisë.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 07:18

Nafta në Shqipëri kushton 2.6 herë më shumë se mesatarja e gjithë Europës, ndaj fuqisë blerëse

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 07:16

Kontratat 1 euro, hapet rruga për blerjen e pronës, shteti mund ta rimarrë nëse shkelen kushtet

Nëse investitori nuk e përmbush këtë detyrim, udhëzimi i jep Ministrisë së Ekonomisë të drejtën të zgjidhë kontratën e shitjes në mënyrë të njëanshme.

"Ministria përgjegjëse ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e shitjes [...] me rikthimin e pasurisë së privatizuar në pronësi të shtetit dhe me të drejtën për të mbajtur shumën e paguar më parë nga blerësi për blerjen e pasurisë", përcakton udhëzimi nr. 7.

Blerësi gjithashtu nuk mund t'ia tjetërsojë pronën një pale të tretë deri në realizimin e plotë të investimit. Udhëzimi përcakton se ky ndalim "përbën hipotekë ligjore mbi pasurinë" dhe pasqyrohet në regjistrin kadastral.

Ndërkohë, udhëzimi nr. 6 vendos rregulla të veçanta për zbatimin dhe monitorimin e kontratave me tarifën simbolike 1 euro.

Për mosrealizimin e investimit të përcaktuar në kontratë, "subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës penalizohet me 10 për qind të vlerës së investimit të përcaktuar", sipas udhëzimit nr. 6.

I njëjti udhëzim vendos edhe një penalitet për mosrealizimin e punësimit të premtuar. "Për çdo vend pune të përcaktuar [...] subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës penalizohet me 50,000 lekë". Numri i vendeve të punës përcaktohet mbi bazën e mesatares vjetore të deklaruar pranë administratës tatimore.

Udhëzimi nr. 6 kërkon që investimet e realizuara të kontrollohen përmes raportit të audituesit ligjor dhe ekspertit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, bilancit financiar dhe aktit të përbashkët të monitorimit. Kur investimi rezulton në nivelin e përcaktuar në kontratë, miratohet kthimi i garancisë së ngurtësuar.

Po ky udhëzim ndryshon edhe mënyrën e zhvillimit të procedurave për dhënien me qira ose enfiteozë të pronave shtetërore. Pas publikimit të konkurrimit, "komunikimi ndërmjet institucionit dhe ofruesve, administrimi i dokumentacionit dhe çdo veprim procedural gjatë konkurrimit zhvillohen vetëm nëpërmjet adresës zyrtare elektronike të institucionit".

Udhëzimi nr. 6 përcakton gjithashtu mënyrën e llogaritjes së tarifës dysheme për pronat shtetërore. Për ndërtesat, tarifa mujore minimale për metër katror është 0.3% e vlerës mesatare të shitblerjes së banesave në bashkinë ku ndodhet prona. Në shembullin e dhënë në udhëzim për një ndërtesë 100 metra katrorë në Tiranë, detyrimi minimal llogaritet në 37,295 lekë në muaj.

Monitorimi i kontratave, sipas udhëzimit nr. 6, përfshin pagesën e qirasë, kamatëvonesat dhe penalitetet, realizimin e investimeve dhe nivelin e punësimit. Njësia përgjegjëse duhet të hartojë aktet e përbashkëta të monitorimit të paktën një herë në gjashtë muaj./Monitor

qeveria prona kushtet

Sondazh

Poll

AKTUALITET 14 SHTATOR 2020, 22:25

Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Reuters: Vendimi mund të trondisë raportet e Kosovës me Perëndimin

më të klikuarat



Pse bën foto? Rama kap të riun nga qafa dhe ia dorëzon policisë, çfarë ndodhi në Aeroportin e Napolit? (VIDEO)

"Mbaje mend do të vras"/ Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, Policia: Materialet u referuan në Prokurori për 3 vepra penale

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

Ilir Meta del nga kafazi/ Apeli i GJKKO pranon kërkesën: Gjatë seancave do qëndrojnë krah avokatit

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by tomorrow.

15 Shtator 2026, 07:10

Kthjellime dhe vranësira, parashikimi i motit për sot

Foto ilustruese TIRANA- Dita e martë pritet të sjellë kushte atmosferike relativisht të paqëndrueshme në vendin tonë. Mot...

Mbyllet protesta e 107-të, qytetarët thirrje në kor: Rama jepe dorëheqjen

Aktualitet

14 Shtator 2026, 22:59

107 ditë revoltë! Qytetarët nuk heqin dorë, marshojnë rrugëve të Tiranës: Polici këtu na ke, ti mbron krimin dhe jo ne(VIDEO)

Aktualitet

14 Shtator 2026, 22:50

BIRN: I dërguari i Trump, me mision lobimi në Tiranë për rizgjedhjen e kreut të FIFA

Aktualitet

14 Shtator 2026, 22:24

Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Reuters: Vendimi mund të trondisë raportet e Kosovës me Perëndimin

Aktualitet

14 Shtator 2026, 22:25

Aktualitet

14 Shtator 2026, 21:49

Protesta e 107-të/ Qytetarët vendosen përballë bllokut të sigurisë, thirrje: Arrestoni Ramën, lironi qytetarët

Pamje nga marshimi i protestuesve TIRANË- Protesta në Tiranë vjon ende edhe në këto momente. Pas mbylljes së fjalimeve të...



"Shkonë në Vlorë dhe bëni çtarrë te doni"/ Përgjimet e reja të Roni Yeffet: Ministrinë e Energjetikës ma lini mua! Mos nisni asnjë letër zyrtare, merrem unë me ta (VIDEO)

Aktualitet

14 Shtator 2026, 21:37

Rrahja barbare e indianit në Greqi, tre të arrestuar, mes tyre dy shqiptarë

Aktualitet

14 Shtator 2026, 21:22

Pesë shkolla në Astir? Tre vite nga premtimi i Veliajt, asnjë godinë e përfunduar

Aktualitet


14 Shtator 2026, 20:43

Përfundojnë fjalimet para Kryeministritë, qytetarët marshojnë drejt bllokut të sigurisë, thirrje: Lironi çunat e diasporës

Aktualitet

14 Shtator 2026, 20:50

MË SHUMË



Përfundojnë fjalimet para Kryeministritë, qytetarët marshojnë drejt bllokut të sigurisë, thirrje: Shqipëri e Re



Përfundojnë fjalimet para Kryeministritë, qytetarët marshojnë drejt bllokut të sigurisë



Pagat e magistratëve/ Braçe i ashpër me KLGJ dhe KLP: Në thesarin e shtetit nuk fut dorën kushdo



Braçe kritika të ashpra ndaj KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Të kërkojnë falje



Berisha: Trump denoncoi rezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Durrës

Përfundojnë fjalimet para Kryeministritë, qytetarët marshojnë drejt bllokut të sigurisë

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta,

AKTUALITET
POLITIKE

Drejtör: Enton Abilekaj
Kryeredaktor: Izmir Akulli

ka media ne shtetom te parive apo biznesit, por ka edhe te pavarura, qe kane zgjedhur rrugën më të vërtetë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444

Email: [\[email protected\]](#)



[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

MBUNDËSHKARËNGA  Mediadesk

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.